



## **FTESË PËR PJESËMARRJE NË TAKIMIN KONSULTUES PËR PËRCAKTIMIN E FUSHAVE TË PËRPARËSIVE NË KUADËR TË THIRRJES SË PARË PUBLIKE PËR ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE NË BASHKINË DIVJAKË**

**Bashkia Divjakë** në kuadër të bashkëpunimit me Programin Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 3 (ReLOaD3), një iniciativë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (PNUD), ka filluar procesin e përgatitjes së Thirrjes së Parë Publike për Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të).

Hapi i parë i këtij procesi është konsultimi me OSHC-të i tematikave që do të shërbejnë për të vendosur përparësitë e thirrjes. Për këtë qëllim, bazuar në dokumentët strategjikë ekzistues, Bashkia **Divjakë** ka përzgjedhur prioritetet më emergjente të cilat kanë nevojë të konsultohen dhe validohen në bashkëpunim me Organizatat e Shoqërisë Civile.

Të gjitha OshC-të e interesuara për t'u bërë pjesë e këtij procesi, janë të ftuara të marrin pjesë në konsultimin publik në përzgjedhjen e përparësive që do të organizohet në datë **20 Nëntor 2025**, ora **10:00** në **ambjentin e Bashkisë, Salla e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Kati 2**.

Më poshtë do të gjeni rendin e ditës dhe çështjet kryesore për diskutim:

- Prezantim i projektit ReLOaD3;
- Diskutimi / konsultimi i përparësive të propozuara për Thirrjen e Parë publike për OshC-të në Bashkinë Divjakë, si vijon:

### **1. Rinia**

1.1 Nxitja e pjesëmarrjes aktive të të rinjve në Divjakë, me fokus të rinjtë që jetojnë në njësitë administrative.

- **Forcimi i pjesëmarrjes qytetare të të rinjve në vendimmarrje lokale**  
Aktivitetet që synojnë përfshirjen e të rinjve në proceset konsultuese të bashkisë, ngritjen ose fuqizimin e këshillit rinor lokal, ngritjen e grupeve rinore informale në njësitë administrative, si dhe nxitjen e dialogut mes të rinjve dhe strukturave të qeverisjes vendore për çështje që lidhen me komunitetin.
- **Fuqizimi i të rinjve në zonat rurale përmes aktiviteteve komunitare dhe vullnetarizmit**  
Nisma që inkurajojnë të rinjtë në njësitë administrative të angazhohen në veprimtari vullnetare, ndërmarrje sociale, ose projekte komunitare (mjedis, kulturë, solidaritet), duke ndërtuar aftësi praktike dhe ndjenjën e përgjegjësisë qytetare.

## 1.2 Organizimi i aktiviteteve sportive dhe kulturore për të rinjtë në Divjakë:

- **Promovimi i sportit dhe stilit të shëndetshëm të jetesës të të rinjtë**  
Aktivitetet që synojnë përfshirjen e të rinjve në sporte individuale dhe kolektive (futboll, volejball, basketboll, atletikë, etj.), organizimi i turneve sportive ndërshkollore apo komunitare, si dhe promovimi i mënyrave të jetesës aktive dhe të shëndetshme.
- **Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike për përfshirjen sociale të të rinjve**  
Nisma që nxisin pjesëmarrjen e të rinjve në evente kulturore, festivale, ekspozita arti, konkurse të talenteve lokale, teatër rinor, muzikë apo aktivitete tradicionale, me qëllim ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe forcimin e identitetit lokal.

## 2. Zhvillim turistik dhe promovimi i kulturës lokale

- 2.1 **Promovimi i potencialeve turistike dhe trashëgimisë kulturore të Bashkisë Divjakë**  
Nisma që synojnë evidentimin dhe promovimin e pikave natyrore, historike dhe kulturore në zonë, përfshirë lagunën, plazhin, traditat lokale, artizanatin dhe gastronominë, me qëllim zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe përfshirjen e komunitetit lokal.
- 2.2 **Krijimi i hapësirave dhe shërbimeve të reja për turizmin dhe kulturën lokale**  
Projekte që mbështesin riorganizimin e zonës së varkave në lagunë si atraksion ekologjik, krijimin e hapësirave muzeale apo ekspozitave kulturore (p.sh. në Kullën 360°), si dhe ngritjen e pikave të informacionit për vizitorët.

## 3 Mbrojtja e mjedisit dhe ndërgjegjësimi komunitar

### 3.1 Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi mjedisor për të rinjtë dhe komunitetin

Aktivitetet që nxisin kujdesin ndaj mjedisit përmes pastrimeve vullnetare, mbjelljeve, aktiviteteve sensibilizuese dhe përfshirjes së shkollave e të rinjve në ruajtjen e biodiversitetit të Parkut Kombëtar Divjakë–Karavasta.

### 3.2 Nisma për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe reduktimin e ndotjes

Projekte që promovojnë ndarjen e mbetjeve në burim, riciklimin, përdorimin e materialeve të qëndrueshme dhe zgjidhje inovative për ruajtjen e ekosistemeve lokale dhe zonave turistike.